



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

## BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 42 14 Tetor – 20 Tetor 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 35 NJVKSH ose 97.2% (=35/36) e tyre

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZH, LUSHNJE, MAT, MIRDITË, M. MADHE, PËRMET, PEQIN, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, MALLAKASTËR, TROPOJË, VLORË.

### NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 42

	JAVA 42
DIARRE PA GJAK	2169
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7860
INF. RESP. TE POSHTËME	3228
RASH ME TEMPERATURË	14
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	425
% e Njësive Raportuese	97% (425/438)

**Rash me temperaturë**


Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Tiranë – 8 raste


Fier – 6 raste

### Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rritje në javën 42 krahasuar me javën paraardhëse, java 41.

### Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ulje në javën 42 krahasuar me javën paraardhëse, java 41.

**Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000**




**Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 30 – 42 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.**




Në javën 42 të vitit 2024 vërehet prirje e qëndrueshme e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


**Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)**



**Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 41 dhe 42 / 2024. Incidenca (raste/10.000)**




**Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 30 – 42 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve**



Në javën 42 të vitit 2024 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

**Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 41 dhe 42/ 2024. Incidenca (raste/10.000)**



**Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” per NJVKSH me rritje nga java 41 dhe 42/ 2024. Incidenca (raste/10.000)**

## Ngjarje kombëtare

### 1. *Situata epidemiologjike e infeksionit nga virusi i Nilit perendimor (Shtojca 1)*

- Gjatë periudhës Korrik – 21 tetor 2024, nga 316 rastet e testuara, 106 raste janë konfirmuar nëpërmjet serologjisë dhe diagnozës molekulare
- Pacientet janë kryesisht persona të moshës mbi 60 vjec dhe kryesisht meshkuj.
- Rastet janë kryesisht të shtruar në shërbimin e sëmundjeve infektive në QSUT dhe kanë paraqitur shenja klinike si: temperaturë, ethe, dhimbje koke, pështjellime, fotofobi, konvulsione, pagjumësi, ngrirje të muskujve të qafes, ndryshime frymëmarrje, incontincë urinare etj.
- Rastet e konfirmuara dhe të mundshme kanë paraqitur kryesisht encefalit ose meningit aseptik.
- Rastet janë të shpërndara në disa bashki ku mbizoterojnë kryesisht bashkitë e Lushnjës, Fierit, Tiranës, Vlorës dhe Beratit.
- Janë kryer hetimet entomologjike ku janë gjetur në këto zona vektorët përkatës të mushkonjave Culex në format adulte dhe janë marrë disa masa në lidhje me dezinfektimin me adulticid të vektorëve nga bashkitë përkatëse sipas udhëzimeve të ISHP duke zbatuar rregullat e caktuara për të mvnjanuar dëmtimin e popullatës dhe qenieve të gjalla të mjedisit.

## Ngjarje ndërkombëtare

### 2. *Zbulimi i cVDPV2 në një mostër të ujërave të zeza, Barcelona, Spanjë*

- cVDPV2 është zbuluar nga një kampion i vetëm mjedisor i mbledhur më 16 shtator nga zona metropolitane e Barcelonës.
- Nuk është zbuluar asnjë rast i paralizës flaksidë akute në komunitet.
- Ky është zbulimi i parë i një kampioni mjedisor pozitiv për cVDPV2 në Spanjë.
- Përpjekjet e vazhdueshme janë të nevojshme në të gjitha vendet e BE/ZEE për të ruajtur mbulimin e lartë të vaksinimit në popullatë dhe parandalimin e rifutjes dhe përhapjes së poliovirusit.

### 3. *Zbulimi i cVDPV3 në mostrat mjedisore në Guajanën Franceze*

- cVDPV3 është zbuluar nga tre mostra mjedisore të mbledhura në maj, qershor dhe gusht nga tre vende grumbullimi në Guajanën Franceze.



- Nuk është zbuluar asnjë rast paralize.
- Ky është zbulimi i parë i një kampioni mjedisor pozitiv për cVDPV3 në Guajanën Franceze.
- Përpjekjet e vazhdueshme janë të nevojshme në të gjitha vendet e BE/ZEE për të ruajtur mbulimin e lartë të vaksinimit në popullatë dhe parandalimin e rifutjes dhe përhapjes së poliovirusit.

#### ***4. Denge e fituar lokalisht në 2024 në Francën kontinentale***

- Në vitin 2024 dhe që nga 16 tetori, janë raportuar 80 raste të dengës së fituar në nivel lokal në Franca kontinentale.
- Rastet janë raportuar në departamentet e mëposhtme: Alpes-Maritimes (17 raste), Drôme (2 raste), Hérault (3 raste), Pyrénées-Orientales ose Lozère (2 raste), Vaucluse (18 raste) dhe Var (38 raste).
- Hetimet janë në vijim dhe po kryhen masat e kontrollit të vektorit.

#### ***5. Infeksioni i dengës i fituar lokalisht në Itali – 2024***

- Në vitin 2024, që nga 15 tetori, janë raportuar 194 raste të dengës së fituar në nivel lokal në Marche (136 raste), Emilia Romagna (36 raste), Lombardia (10 raste), Abruzzo (8 raste), Toskana (2 raste) dhe rajonet Veneto (1 rast) në Itali. Një vend i infeksionit aktualisht është nën hetim.
- Hetimet janë në vijim dhe masat e kontrollit të vektorit janë nisur nga autoritetet shëndetësore italiane në përputhje me planin e tyre kombëtar të reagimit.

#### ***6. Mpox për shkak të virusit të lisë së majmunëve të klasit I dhe II - 2024***

- Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në situatën epidemiologjike lidhur me qarkullimin e virusit të lisë së majmunit (MPXV) kladi I dhe kladi II gjatë javës së kaluar.
- Ndër vendet që kishin raportuar më parë raste të klasit Ib, Republika Demokratike e Kongo (DRC), Burundi, Kenia dhe Uganda kanë raportuar raste të reja javën e kaluar.
- Rastet Mpox (kladi nuk është përcaktuar ende) janë raportuar këtë javë në Zimbabve.
- Asnjë transmetim dytësor i MPXV clade Ib nuk është raportuar në Suedi, Tajlandë ose Indi (vendet jashtë Afrikës ku MPXV clade I është zbuluar).
- ECDC është duke monitoruar dhe vlerësuar nga afër situatën epidemiologjike.